



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:146900
Datë: 17.05.2024
Numri i dokumentit: 05699774

E.nr.1130/23

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi dhe sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përmbarimore të kreditores D.K. nga Ferizaj, të cilën e përfaqëson av Zejnije Bega nga Ferizaj, kundër debitorit Komuna e Ferizaj - Drejtoria Komunale e Arsimit Ferizaj, për pagesën e shtesës së papaguara, ushqimit, udhëtimit dhe shpenzimeve të procedurës, më datë 15.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përmbarimore në lëndën **E.nr.1130/23**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditores.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.1130/23, të datës 03.08.2023 e ka caktuar përmbarimin e propozuar nga i autorizuari i kreditores, kundër debitorit Drejtoria Komunale e Arsimit në Ferizaj, për pagesën e shtesës së papaguar, ushqimit, udhëtimit dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të pajtimit gjyqësor 2022:205790, të dt.22.06.2023.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbarimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 06.10.2023, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 686.00 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditores.

Meqenëse kreditorja e ka realizuar kërkesën e saj, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbarimore në këtë çështje juridike përmbarimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
E.nr.1130/23, më datë 15.05.2024

GJYQTARI
Faton Ajvazi